

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në Departamentin e Inxhinierisë Informatike si më poshtë:

A. Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektorë” pranë Departamentit të Inxhinierisë Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor +Master i Shkencave) të studimeve në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (UPT) në fushën e Inxhinierisë Informatike;
2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave ≥ 8.5 dhe notë 9 ose 10 në lëndët specifike Algoritëm, Programim i avancuar dhe Programim në web;
3. Të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze dhe niveli C1;
4. Preferohet të kenë botime të artikujve në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN, si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings me kod ISBN;
5. Preferohet të kenë të paktën 3 vite eksperiencë pune në mësimdhënie pranë institucioneve të arsimit të lartë (me kohë të plotë ose pjesshme);
6. Të ketë dy rekomandime nga personeli akademik i FTI, UPT me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DII, FTI.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **03.02.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.